Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Developement

TREGU I BORONICËS

Prill, 2019

DEPARTAMENTI I ANALIZAVE EKONOMIKE
DHE STATISTIKAVE BUJQËSORE

ANALIZA E TREGUT TË BORONICËS

Prill, 2019

Tabela e përmbajtjes

Parathënie **3**

1 Tregu i boronicës **4**

2 Prodhimtaria vendore **4**

3 Zhvillimi i tregtisë **5**

3.1 Importi i boronicës 5

3.2 Eksporti i boronicës 6

3.3 Eksporti i boronicës sipas vendeve 7

3.4 Bilanci tregtar i boronicës 7

4 Çmimet e tregut **8**

4.1 Çmimet vendore 8

4.2 Çmimet e importit 9

5 Madhësia e tregut **9**

6 Mbështetja e prodhimtarisë së boronicës **10**

6.1 Pagesat direkte për kulturën e boronicës 10

6.2 Masat e zhvillimit rural që e përkrahin sektorin e pemëve - Boronicën 10

7 Sfidat për kultivimin e boronicës **12**

8 Konkluzionet dhe rekomandimet **13**

Parathënie

Pemëtaria është njëri ndër sektorët me potencialin më të lartë zhvillimor në Kosovë. Fermerët të cilët merren me kultivimin e pemëve, duke parë përfitimet ekonomike që është duke u sjellur ky sektor, janë orientuar drejt rritjes së prodhimtarisë, sipërfaqes së mbjellur, duke zëvendësuar kështu në një përqindje edhe sasinë e importuar.

Analiza e tregut të boronicës është një ndër analizat e shumta e punuar në mënyrë të detajuar nga Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore (DAESB). Qëllimi kryesor i punimit të kësaj analize është të shërbej si një dokument në të cilin janë të përmbledhura të gjitha të dhënat statistikore të cilat pasqyrojnë gjendjen e tanishme si dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të kulturës së boronicës në vendin tonë.

Në këtë analizë më gjerësisht shtjellohen të dhënat mbi prodhimtarinë vendore, pasqyra e eksportit dhe importit të boronicës, çmimet e boronicës vendore si dhe atyre të importuara, madhësia e tregut, zhvillimi i tregtisë, mbështetja nga MBPZHR-ja përmes pagesave direkte dhe masave të zhvillimit rural si dhe në fund konkluzionet finale mbi këtë analizë.

1 Tregu i boronicës

Kushtet klimatike e bëjnë të mundur që kultivimi i boronicës në vendin tonë të sjellë përfitime për fermerët të cilët merren me kultivimin e kësaj kulture. Gjatë vitit 2017 prodhimtaria e përgjithshme e pemëve ishte 34,207 tonë, kurse pjesëmarrja e boronicës në prodhimtarinë e përgjithshme të pemëve ishte vetëm 0.8%. Në figurën e mëposhtme janë paraqitur sipërfaqet e mbjellura me boronicë sipas regjioneve në vendin tonë, të siguruara nga Regjistrimi i Ekonomive Bujqësore, i vitit 2014. Nga figura 1 shihet se në regjionin e Gjakovës është mbjellur sipërfaqja më e madhe gjatë vitit 2014 (55%), pastaj në Prizren (29%), Gjilan (14%) dhe në Ferizaj (2%).

Figura 1: Sipërfaqja e mbjellur sipas regjioneve gjatë vitit 2014



Burimi: ASK - Regjistrimi i bujqësisë 2014, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

2 Prodhimtaria vendore

Në vitin 2017 prodhimtaria vendore e boronicës ishte 271 tonë. Prodhimtaria vendore në Kosovë arrin të plotësoj nevojat vendore për konsum të boronicës duke arritur të eksportoi gjithashtu një sasi prej 23 tonë. Prodhimtaria totale në vitin 2017 krahasuar me vitin 2016 shënoi rritje prej 43%, kjo erdhi si rezultat i rritjes së sipërfaqes së kultivuar për 18 ha.

Figura 2: Sipërfaqja e kultivuar me boronicë në ha (majtas) dhe prodhimtaria e boronicës në tonë (djathtas)



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

3 Zhvillimi i tregtisë

Në aspektin e tregtisë sasia më e madhe e prodhimtarisë vendore nga fermerët shitet në treg, ndërsa një sasi e vogël përdoret për nevoja familjare. Gjatë vitit 2017 vendi ynë ka eksportuar 23 tonë boronicë, ndërsa gjatë vitit 2018 ka eksportuar 99 tonë boronicë që kryesisht janë eksportuar në Serbi.

3.1 Importi i boronicës

Në figurën 3 është paraqitur importi i boronicës gjatë periudhës kohore 2010-2018. Importi i boronicës në vitin 2018 ishte 4 tonë, që për dallim nga viti 2017, kishte ngritje të sasisë së importuar për 55%. Nga figura mund të vërejmë se importi i boronicës ka qenë në luhatje të vazhdueshme. Sasia më e madhe e importuar shihet se ishte në vitin 2011 me 10.2 tonë, ndërsa sasia më e vogël e importuar ishte në vitet 2013 dhe 2014 me nga 320 kg boronicë.

Figura 3: Importi i boronicës gjatë viteve 2010-2018 në tonë



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Importi i boronicës gjatë vitit 2017 ishte vetëm nga Kroacia, ku gjithsej janë importuar 8.9 tonë. Ndërsa në vitin 2018 kemi sasi të importuar të boronicës nga Kroacia (59%), Polonia (38%), Spanja (2%) dhe nga Kili (1%).

Figura 4: Importi i boronicës sipas vendeve gjatë vitit 2018



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

3.2 Eksporti i boronicës

Gjatë vitit 2013 sasia e boronicës së eksportuar ishte 508 tonë, me këtë sasi vendi ynë shënon edhe pikën më të lartë të sasisë së eksportuar gjatë periudhës kohore 2010-2018. Në figurën 5 është paraqitur sasia e boronicës së eksportuar gjatë periudhës '10-'18. Nga figura mund të shihet se eksporti në vite ka qenë në luhatje ndërsa krahasuar me vitin 2013 sasia e eksportuar në vitin 2014 ishte më e ulët për 66%. Sasia e eksportuar, në vitin 2010 ishte (1 tonë), 2011 (163 tonë), 2012 (152 tonë), 2013 (508 tonë), 2014 (169 tonë), 2015 (6 tonë), 2017 (23 tonë) dhe 2018 (99 tonë). I vetmi vit gjatë kësaj periudhe që nuk kishte eksport të boronicës ishte viti 2016.

Figura 5: Eksporti i boronicës gjatë viteve 2010-2018 në tonë



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

3.3 Eksporti i boronicës sipas vendeve

Gjatë vitit 2017 vendi ynë sasinë më të madhe të boronicës e eksportoi në Rumani me 83% dhe në Itali me 17%. Ndërsa gjatë vitit 2018 e gjithë sasia e boronicës së eksportuar ka qenë e orientuar në Serbi.

Figura 6: Eksporti i boronicës sipas vendeve gjatë viteve 2017



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

3.4 Bilanci tregtar i boronicës

Bilanci tregtar i boronicës gjatë periudhës 2010-2018 ka pasur luhatje të mëdha nga viti në vit. Eksporti në vitin 2018 kishte vlerën prej 203 mijë €, kurse importi rreth 10 mijë €, duke rezultuar me bilanc tregtar pozitiv prej 193 mijë € në vitin 2018. Duke filluar nga viti 2011 në periudhën pasuese deri në vitin 2013 bilanci tregtar i boronicës kishte ngritje të vazhdueshme. Raporti në mes eksportit dhe importit është paraqitur në figurën e mëposhtme ku shohim se bilanci tregtar më i lartë për boronicën ka qenë në vitin 2013 (725 mijë €). Ndërsa i vetmi vit që kishte bilanc tregtar negativ ishte viti 2016 me vlerë prej 2 mijë €.

Figura 7: Vlera e bilancit tregtar për boronicën, në 1000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

4 Çmimet e tregut

Tregu i boronicës në vendin tonë ka kërkesa të vazhdueshme, duke pasur parasysh se boronica është e njohur si frut i shijshëm por edhe me vlera të shumta ushqyese, po ashtu edhe shëruese.

Sasia më e madhe nga prodhimtaria e boronicës në vendin tonë përdoret për konsum familjar, ndërsa pjesa tjetër shitet në tregun vendor dhe në tregun e jashtëm që kryesisht eksportohet në Serbi, Itali, Austri etj. Prandaj edhe çmimet ndryshojnë nga viti në vit varësisht nga sasia e prodhimit që gjendet në treg.

4.1 Çmimet vendore

Boronica vendore është e pranishme në treg gjatë muajit qershor, korrik, gusht dhe shtator. Në figurën e mëposhtme është paraqitur lëvizshmëria e çmimeve vendore të boronicës gjatë periudhës 2013-2018. Gjatë vitit 2013 siç mund të shihet edhe në figurën 8, çmimet mesatare të shitjes së boronicës vendore ishin 8.7 €/kg dhe ky vit shënon edhe vlerën më të lartë të shitjes së boronicës në këtë periudhë kohore. Viti 2016 dhe viti 2018 shënojnë edhe pikën më të ultë të çmimit të shitjes së boronicës me 8 €/kg.

Figura 8: Çmimet e shitjes së boronicës vendore (€/kg)



Burimi: DAESB-MBPZHR

Në figurën 9 është paraqitur lëvizshmëria e çmimeve të boronicës vendore përgjatë periudhës kohore kur boronica vendore është e pranishme në tregun vendor. Çmimi më i lartë ishte në muajin korrik ndërsa çmimi mesatar gjatë këtyre muajve ishte 8.5 €/kg me pakicë dhe 7.4 €/kg me shumicë.

Figura 9: Çmimet e shitjes së boronicës vendore për vitin 2017 (€/kg)



Burimi: DAESB - MBPZHR

4.2 Çmimet e importit

Në figurën e mëposhtme janë paraqitur çmimet e importit me shumicë dhe pakicë për periudhën kohore '14-'18. Çmimi mesatar me shumicë gjatë viteve 2014-2018 ka qenë 4.5 €/kg, ndërsa çmimi mesatar me pakicë ka qenë 10.5 €/kg.

Figura 10: Çmimet e shitjes së boronicës së importuar (€/kg)



Burimi: DAESB - MBPZHR

5 Madhësia e tregut

Tregu i përgjithshëm i boronicës në vendin tonë gjatë vitit 2017 vlerësohet të ishte rreth 274 tonë, duke përfshirë gjithë prodhimtarinë vendore dhe importin e boronicës si produkt i freskët dhe po ashtu si produkt i përpunuar.

Nga të dhënat e prodhimtarisë vendore si dhe nga të dhënat e tregtisë për vitin 2017, konsumi i përgjithshëm i boronicës për kokë banori në Kosovë është rreth 0.14 kg në vit.

6 Mbështetja e prodhimtarisë së boronicës

6.1 Pagesat direkte për kulturën e boronicës

Programi i pagesave direkte është ndër shtyllat kryesore të mbështetjes që jep shteti për fermerët e vendit tonë. Objektivat që tentohen të arrihen përmes pagesave direkte për kulturën e boronicës janë:

- Rritja e të hyrave në fermë dhe përmirësimi i konkurrencës;
- Mirëmbajtja e vazhdueshme e pemishteve ekzistuese;
- Zvogëlimi i kostos së prodhimit;
- Përmirësimi i cilësisë së prodhimit;
- Rritja e rendimentit.

Kultivuesit e boronicës për të përfituar nga programi i pagesave direkte duhet të kenë të mbjellura së paku sipërfaqe prej 0.20 ha parcelë e pandarë. Në rast se fermeri merr tokë me qira gjithashtu edhe sipërfaqja e marrë me qira duhet të jetë së paku 0.20 ha e pandarë, e dokumentuar përmes kontratës si dhe e kontraktuar në periudhën prej së paku një vit. Subvencionimi në formë të pagesave direkte do të bëhet për sipërfaqe të mbjellura me boronicë në vlerë prej 400 €/ha.

6.2 Masat e zhvillimit rural që e përkrahin sektorin e pemëve - Boronicën

Në kuadër të masave të zhvillimit rural boronicat do të përkrahen në kuadër të masës 101, Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore.

Objektiva të përgjithshme të kësaj mase janë: rritja e aftësisë konkurruese të bujqësisë kosovare dhe zëvendësimi i importit, krijimi i vendeve të reja të punës, përkrahja e bujqve në sektorët e përzgjedhur, me qëllim të përafrimit me rregullat, standardet, politikat dhe praktikat e BE-së, përkrahja e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror, adresimi i sfidave të ndryshimit klimatik përmes shfrytëzimit të energjisë së ripërtërishme.

Objektivat specifike që kanë të bëjnë me sektorin e pemëve janë: rritja e prodhimit të pemëve dhe perimeve për qëllime komerciale, modernizimi i fermave përmes përdorimit të pajisjeve të reja, zvogëlimi i humbjeve pas vjeljes nëpërmjet investimeve në fermë, në teknologjinë e ruajtjes, në kapacitetet për ftohje, klasifikim dhe paketim, prodhimi i energjisë së ripërtërishme.

Fermerët në momentin e aplikimit për investime në sektorin e pemëve, duhet të dëshmojnë se kanë sipërfaqe të tokës bujqësore në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira për së paku 10 vjet të llogaritur nga viti i aplikimit dhe atë së paku 1 hektar, sipërfaqja minimale e ngastrës duhet të jetë 0.35 hektar. Përfituesit për ngritje të pemishteve të reja, para kërkesës për pagesë, nëse blejnë

fidanë të prodhuar në Kosovë, duhet të dorëzojnë kopjen e certifikatës fito-sanitare mbi gjendjen shëndetësore të materialit fidanor që përmbush kriterin CAC (Conformitas Agraria Communitatis) dhe kopjen e licencës së prodhuesit. Gjithashtu fidanët e mbjellë të pemëve drufrutore duhet të kenë të ngjitur në trup etiketën e institucionit certifikues.

Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt brenda kësaj mase është 3,000 € ndërsa vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt brenda kësaj mase është 100,000 €.

Në kuadër të masës 101, sektori i pemëve-boronica përkrahet edhe në kuadër të masës 103, Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore.

Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt është 30,000 €, ndërsa vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt është 400,000 €. Përkrahja publike është 50% e shpenzimeve të pranueshme të investimit.

Përveç masës 101 dhe 103 sektori i pemëve përkrahet edhe në kuadër të masës 302, Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve.

Masa 302 "Diversifikimi i fermës dhe zhvillimi i bizneseve" synon krijimin e vendeve të reja të punës dhe ruajtjen e atyre ekzistuese.

Në kuadër të investimeve të pranueshme hyjnë: ndërtimi / renovimi / zgjerimi i objekteve për prodhim, ruajtje dhe përpunim të prodhimeve, investimet në makina dhe pajisje për përpunimin e pemëve dhe perimeve, klasifikim, grumbullim, ruajtje, frigorifer me ftohje, me ngrirje etj, me qëllim të përmirësimit të sigurisë dhe cilësisë së ushqimit.

Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt, për të gjitha nën masat e kësaj mase është 5,000 €.

Përkrahja publike është 65% e shpenzimeve të pranueshme të investimit. Përkrahje shtesë prej 5% jepet për investime në zonat malore.

7 Sfidat për kultivimin e boronicës

Rritja e sipërfaqes së mbjellur me boronicë, sasia e eksportuar e boronicës etj, konsiderohen si të arritura në kultivimin e kësaj kulture të rëndësishme për ekonominë e vendit tonë, mirëpo përveç të arriturave të konsiderueshme ekzistojnë disa probleme të cilat vazhdojnë të jenë sfida për fermerët e vendit tonë. Kultivuesit e boronicës vazhdojnë të ballafaqohen me mungesën e sistemit të ujitjes, e po ashtu ata po përballen edhe me kushtet klimatike, dëmet të cilat herë pas here po ua shkakton breshëri. Një ndër problemet kryesore të kultivuesve të vegjël të boronicës dhe grumbulluesve (mbledhësve) të boronicës të rritura në shpatet e maleve është mungesa e dhomave frigoriferike për t'i mbajtur boronicat e freskëta. Kjo ndikon që kompanitë që bëjnë grumbullimin e boronicës ta marrin boronicën me çmim relativisht më të ulët se çmimi i tregut nga kultivuesit dhe grumbulluesit e boronicës, nga pamundësia për ti ruajtur frutat e freskët.

Sa i përket tregtimit të boronicës nga kompanitë grumbulluese, mund të themi se nuk është evidentuar ndonjë problem apo pengesë, sepse këto kompani paraprakisht bëjnë marrëveshje (lidhin kontratë) me kompanitë nga vende të ndryshme të rajonit dhe BE-së. Pastaj, bëjnë grumbullimin e boronicës nga kultivuesit vendorë dhe grumbulluesit e boronicës të rritur në male, bëjnë deponimin e tyre në ambiente të kontrolluara dhe pastaj i plasojnë sipas marrëveshjes.

Mungesa e fidanëve cilësor të prodhuar sipas standardeve të larta ndërkombëtare është një sfidë tjetër për kultivuesit e boronicës dhe fermerët e rinjë.

8 Konkluzionet dhe rekomandimet

Nga të dhënat e paraqitura për analizën e tregut të boronicës si konkludim mund të themi se sipërfaqja e mbjellur me këtë kulturë dhe eksporti kanë qenë në rritje të vazhdueshme viteve të fundit. Nga gjendja e tanishme si rezultat i kultivimit të boronicës vendi ynë ka arritur që sasinë e importuar ta zvogëlon.

Vazhdimi i rritjes së sipërfaqes së mbjellur me boronicë do të kishte ndikim në uljen e vlerës negative të bilancit të përgjithshëm tregtarë në vendin tonë, prandaj krijimi i kushteve të avancuara për kultivimin e kulturës së boronicës dhe po ashtu rritja e sipërfaqes së mbjellur me boronicë shihet si prioritet për vitet e ardhshme.